



RAPORT MONITORIMI
MJEDISI & TURIZMI
Maj-Korrik 2020



AUTOR
Tea Zeqaj

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Around the World

www.qeverisja.qq.com.al

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është një nga ministritë më pak të prioritarizuara dhe buxhetuara nga shteti. Kësaj ministrie shpesh herë i duhet të bëjë kompromise me nevojën e vendit për një ekonomi më të qëndrueshme, tendencën për prodhim energjie duke sakrifikuar lumenjtë, etjen për ndërtim në brendësi të Zonave të Mbrojtura, ndotjen që shkaktojnë bizneset me ndikim të lartë në PBB (Produktin e Brendshëm Bruto) të vendit dhe si rrjedhojë shpesh herë përballet edhe vet brenda ministrisë me ndikimet negative që ka turizmi në mjedis.

Një nga sfidat më të mëdha të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit por edhe të vet Qeverisë është **Menaxhimi i Mbetjeve Urbane**, duke e konsideruar çështjen si një nga gjashtë prioritetet e saj dhe duke i dhënë rëndësi të madhe trajtimit dhe depozitimit fundor të mbetjeve.

Në 5 qershor 2020, në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, ministri Klosi¹ promovoi incinerimin si metodën e cila do t'i jepte përfundimisht zgjidhje problemit të madh me mbetjet në Shqipëri, me anë të vizitës së tij në tre incineratorët e vendit: Një në Ebasan i cili është në funksion që prej 2017, në Fier dhe në Tiranë të cilët janë ende në ndërtim.

Por si është situata e mbetjeve në Shqipëri? Cili është kuadri ligjor dhe cilët janë përgjegjësit? Çfarë është incinerimi dhe a do t'i japë zgjidhje problemit të mbetjeve në Shqipëri? A është gati vendi ynë për këtë proces dhe ku të na çojnë 3 incineratorët? Cili është mendimi i qytetarëve dhe organizatave mjedisore lidhur me këtë metodë?

Në analizën e mëposhtme, do të përpiqemi t'ju japim përgjigje këtyre dhe të tjera pyetjeve.



¹ Klosi viziton Incineratorët në ditën e Mjedisit (<https://www.youtube.com/watch?v=ARRDMu1npjU>)




Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri

Në Republikën e Shqipërisë, **Bashkitë** janë përgjegjëse për trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve si dhe për menaxhimin e impianteve të trajtimit të tyre referuar VKM nr.687, datë 29.5.2015². Gjithashtu, **Ministria e Bujqësisë, Infrastrukturës & Transportit, Shëndetësisë dhe Ministria përgjegjëse për Industrinë** janë të detyruara nga një sërë vendimesh të raportojnë statistikat vjetore të mbetjeve që gjenerojnë.

Pavarësisht gjithë detyrimeve ligjore, është vlerësuar që **të dhënat mbi sasi të apo ndikimin e mbetjeve në mjedis nuk janë të sakta dhe të mjaftueshme**. Duke qenë se në Shqipëri nuk ka ende grumbullim të diferencuar, të dhënat e sakta mbi sasi të specifikave të llojeve të ndryshme të mbetjeve nuk mund të gjenerohen.

Tre janë mënyrat kryesore të trajtimit të mbetjeve në Shqipëri, Landfillimi (Deponimi), Riciklimi dhe Incinerimi.



➔ **Landfillimi** Gjatë vitit 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Programin Zviceran për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (DLDP) kanë identifikuar në të gjithë vendin **199 venddepozitime ilegale dhe legale**.³ Por në Shqipëri janë në punë vetëm katër landfille: Bajkaj (Sarandë), Bushat (Shkodër), Maliq (Korçë) dhe Sharrë (Tiranë). Gjithashtu, gjenden edhe objekte të tjera, të cilat mund të konsiderohen si venddepozitime të kontrolluara, ndërsa pjesa tjetër e vend depozitimeve aktuale nuk plotësojnë standardet minimale sanitare. **Gjatë vitit 2018 vetëm 26.37% e 923,316 ton mbetjeve u depozitua në landfille sanitare.**

Tabela 2 Venddepozitimet e kontrolluara të mbetjeve në Shqipëri, 2019

Nr.	Landfill ekzistues/në projekt	Sipërfaqja	Kapaciteti (Ton ose m3)	Shënim
1	Bushat (Shkodër)	12 ha	1 000 000 m3	Në veprim
2	Bajkaj (Delvinë)	12.5 ha	600,000 ton	Në veprim
3	Sharrë (Tiranë)	15 ha	2 900 000 ton	Në veprim
4	Rubik (landfill industrial)	5 000 m2	3 500 ton/vit	Në veprim
5	Rrëshen	NA	NA	Në veprim
6	Dibër	8 000 m2	-	Në veprim
7	Papër (Elbasan)	-	9,970 ton	Në veprim
8	Maliq	10 ha	1 000 000 ton	Në veprim
Faza e Ndërtimit				
9	Fier			Në proces
10	Tiranë			Në proces
Faza e Fizibilitetit				
11	Sherishta 1 (Vlorë)	12 ha	1 044 690 m3	SF përfunduar

(Burimi informacionit: MIE).

² VKM nr. 687 (<http://www.mjedisi.gov.al/menaxhimi-i-mbetjeve/>)

³ Dokumenti i politikave strategjike (http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike_AL.pdf)

➔ **Riciklimi** Industria e riciklimit është një zinxhir procesesh, ku përfshijmë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin e cila çon në zvogëlimin e një sasive të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në landfill.

Sipas INSTAT, riciklimi i mbetjeve ka ruajtur afërsisht të njëjtin **nivel treguesish me tendencë në rënie**. Në vitin 2016 u ricikluan 17.2 % e sasisë totale, ndërsa në vitin 2015 u ricikluan 25,3 %, në vitin 2014 21,6 % dhe në vitin 2013 rreth 24,0 %.

Në Shqipëri ka një industri riciklimi të zhvilluar dhe aktive. Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë (SHRSH)⁴ raporton se ka rreth 38 anëtarë, kompani private riciklimi. **Kapaciteti përpunues i industrisë së riciklimit në vend është rreth 498,480 ton/vit, i cili është mëse i mjaftueshëm për të përpunuar të gjitha mbetjet e riciklueshme që gjenerohen në vend.**

Kjo industri për shkak të mungesës së lëndës së parë **ka angazhuar vetëm 26.8 % të kapacitetit prodhues**. Kjo ka bërë që disa nga kompanitë të zvogëlojnë aktivitetin e tyre, disa të mbyllen, ndërsa disa të tjerë po planifikojnë që ti zhvendosin instalimet e tyre në vende të tjera.

Gjithnjë e më tepër, vendet në zhvillim po shkojnë drejt Riciklimit për shkak se ofron avantazhe në: * **kursimin e energjisë**, një kombinim i riciklimit dhe kompostimit mund të kursejë tre deri në katër herë më shumë energji nga sa mund të prodhojë një incenerator⁵. * **Krijon më shumë vende pune**- riciklimi krijon të paktën dhjetë herë më shumë vende pune sesa landfillimi ose djegia. * **Riciklimi është më fleksibël dhe dinamik**- Ri-përdorimi dhe aktivitetet e riciklimit janë jo vetëm miqësore me mjedisin, por ato gjithashtu japin një rezultat shumë më të mirë nga pikëpamja ekonomike dhe sociale.



Sektori i punësimit formal dhe jo formal në grumbullimin e mbetjeve. Në Shqipëri, në vitin 2006 ekzistonin mbi 12,520 grumbullues romë që angazhoheshin në mënyrë informale me mbledhjen e materialeve të riciklueshme⁶. Sipas shoqatës së ricikluesve, vetëm në rajonin e Tiranës angazhohen në këtë sektor rreth 1,200 familje. Ky sektor luan një rol të rëndësishëm dhe praktikisht përfaqëson të vetmin burim që furnizon industrinë e riciklimit me lëndë të parë.

Trajtimi i mbetjeve përmes incinerimit, i cili në rastin e Tiranës, sipas studimit të fizibilitetit do të hapë vetëm 27 vende pune, lë të papunë anëtarët e 1200 familjeve.

⁴ Shoqata e ricikluesve të Shqipërisë <http://www.ara.org.al/>

⁵ J. Morriss and D. Canzonieri, Recycling versus Incineration: An Energy Conservation Analysis, Seattle, Sound Resource Management Group, 1993.

⁶ Sipas një artikulli të Reporter.al i cili i referohet një raporti të IFC – krahu komercial i Bankës Botërore

➔ Incinerimi si metodë për trajtimin e mbetjeve

Incinerimi është procesi i trajtimit të mbetjeve që përfshin djegien e substancave organike që gjenden në materialet e mbetjeve⁷. Në disa raste, nxehësia e krijuar nga djegia mund të përdoret për të gjeneruar energji elektrike.

Elbasan- Në prill të 2017 u inaugurua incineratori i parë në Shqipëri në fshatin Katund i Ri, Elbasan. Incineratori ishte një investim PPP (Partneritet Publik Privat) me kompaninë Albtek Energy me kosto totale prej **21 milion Euro** dhe zotëron një kapaciteti përpunues rreth **120-140 ton/ditë**.

Fier- Nga inaugurimi i Incineratorit në Elbasan, Kryeministri Rama iu bënte thirrje banorëve të fshatit Vëri, të pranonin ndërtimin e një incineratori tjetër në Fier pasi sipas tij ky investim do të sillte punësim, ekonomi dhe zhvillim.⁸ Ndërtimi i incineratorit u miratua me vendimin nr.15 të Këshillit Kombëtar të Territorit në Dhjetor 2017. Incineratori për trajtimin e mbetjeve Fier ka një kosto totale prej **28 milion Euro**. Kapaciteti përpunues do të jetë rreth **180-200 ton/ditë**. Ky projekt ka vonesa në përfundimin e tij, për shkak të protestave të vazhdueshme të banorëve të zonës⁹.

Tiranë- Projekti i tretë është Trajtimi i mbetjeve Tiranë ("Integrated Energy B.V shpk"¹⁰), i cili u shpall fitues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pas një procedure prokurimi me ofertë të pakërkuar. Në gusht 2017 u nënshkrua kontrata për një periudhë koncesionare 30 vjeçare dhe kosto totale **128.248.330 Euro**.

Ndërtimi i tre incineratorëve mori vëmendjen e shumë analistëve, medias dhe sidomos ekspertëve mjedisorë, të cilët analizuan studimin e fizibilitetit dhe kontratën koncesionare për të vlerësuar politikën e incinerimit si metodë për trajtimin e mbetjeve.



⁷ <https://www.inciner8.com/how-an-incinerator-works.php>

⁸ <https://www.monitor.al/ndryshimi-i-politikave-per-mbetjet-urbane-i-kushton-shtronjite-shqiptare/>

⁹ <https://citizens-channel.com/2018/01/24/reportazh-verri-banoret-te-vendosur-kundër-ndërtimit-e-incineratorit/>

¹⁰ Open Corporates at: (<http://opencorporates.al/sq/nuis/17203/0136>)

Sipas Qendrës Mjedisore EDEN¹¹, përpara se të merret një vendim kaq i rëndësishëm duhen marrë në konsideratë një sërë faktorësh, disa prej të cilëve janë:

- **Hierarkia e mbetjeve si parim themelor i menaxhimit**, pra fazat të cilat duhet të kalojë përpunimi i mbetjeve sipas udhëzimeve të Bashkimit Evropian.
- **Përmbushja e standardeve të larta të kontrollit ndaj shkarkimeve në ajër**. Ndotja që shkaktohet nga këto impiante mund të ketë pasoja shumë të rënda në shëndet. Strukturat aktuale në Shqipëri nuk kanë në përmbajtje të tyre staf të aftësuar në zbatim të standardeve të kërkuara për këto impiante.
- **Instalimi i impianteve MpE kërkon një sistem menaxhimi shumë efikas në nivel Bashkie**, i cili siguron që të gjitha mbetjet e gjeneruara grumbullohen dhe transportohen drejt impiantit. Në nivel qarku, bashkitë e vogla nuk e përballojnë financiarisht një sistem transferimi të mbetjeve në Tiranë.

Nga një analizë e shpejtë, për instalimin e një Incineratori në Qarkun e Tiranës, do të duhej të shpenzohej gjysma e buxhetit të vendit vetëm për operimin e këtij impianti.

20 organizata mjedisore dhe ricikluesish, në 6 shkurt 2019 i drejtuan një letër¹² Qeverisë për t'i kërkuar anulimin e projektit të incineratorit të Tiranës, mbështetur në argumentat se "vendimi për djegien e mbetjeve urbane, vjen **në mungesë transparence dhe në kundërshtim me ligjet kombëtare dhe evropiane** për menaxhimin e mbetjeve urbane. **Mungojnë argumentat** që mbrojnë domosdoshmërinë **e kësaj vendimmarrje të nxituar dhe të papërgjegjshme**, duke mos u mbështetur mbi analiza. **Studimi i fizibilitetit nuk trajton asnjë alternativë tjetër të trajtimit të mbetjeve urbane**. Sasia totale e mbetjeve të trajtuara nga impianti në të katërta linjat do të jetë rreth 920 ton/ditë. Kjo sasi e detyron të gjithë Qarkun e Tiranës të ndalojë veprimtarinë ricikluese për të paktën 30 vitet e ardhshme.

¹¹ EDEN "Incinerimi i mbetjeve si qasje vendore" (<http://www.eden-al.org/images/Publikime/Incinerimi-si-qasje-vendore.pdf>)


¹² <https://www.eden-al.org/images/PDF/Leter-pozicionimi-Qndrim-i-organizatave-mjedisore-dhe-ricikluesve-mbi-ngritjen-e-impianit-t-djegies-1.pdf>

Sipas nenit 7 të kontratës koncesionare¹³, Bashkia e Tiranës detyrohet të paguajë **29 Euro** për çdo ton mbetjesh të munguar nga qytetarët në ditë nëse nuk plotësohet minimumi i kërkuar për funksionim 550-700 ton/ditë. Për ta ilustruar, në rast se Qytetarët e Tiranës do të dërgojnë për incinerim 100 ton më pak mbetje në ditë do t'ju kushtoj 2900 Euro/ditë.

Këshilli Bashkiak i Tiranës me anë të vendimit Nr. 40, datë 23.05.2016¹⁴, themeloi kompaninë “Eco Tirana”. Kjo kompani mbulon shërbimin e **mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane të Bashkisë së Tiranës si dhe** disa lloj shërbimesh të tjera, ndër të cilat grumbullimin e diferencuar dhe riciklimin. Sipas vëzhgimeve të ekspertëve¹⁵ **procesi i riciklimit nuk ka funksionuar siç duhet, kryesisht për dy arsye: infrastruktura dhe mungesa e ndërgjegjësimit të qytetarëve.**

Eco Tirana ka një **kohëzgjatje të përcaktuar të veprimtarisë së saj jo më të vogël se 25 vjet. Ndërtimi i incineratorit të Sharrës, me kontratë 30 vjeçare, krijon në këtë territor mbivendosje shërbimi dhe rritje të kostove financiare si rrjedhojë, rritje të Tarifave të pastrimit për qytetarët dhe bizneset e Tiranës.** Bashkia e Tiranës, me anë të vendimit nr. 158 të Këshillit Bashkiak, të marrë në datën 26.12.2019¹⁶ rriti nga **15% deri në 64% tarifat**¹⁷ e pastrimit për qytetarët dhe bizneset.

Në relacionin e Programit Buxhetor Afatmesëm, 2020-2022 të Bashkisë Tiranë argumentohet nevoja për rritjen e tarifave, me rritjen e kostos së shërbimit të lidhur edhe me zbatimin e kontratës koncesionare të incineratorit. **“Në bazë të analizës së kostos së shërbimit të pastrimit dhe përpunimit të mbetjeve, është evidentuar një diferencë e theksuar mes kostos së shërbimit dhe të ardhurave të arkëtuara për mbulimin e tij. Ky ndryshim është diktuar kryesisht për shkak të hyrjes në fuqi të kontratës së incineratorit në vitin 2018 , në bazë të PPP të realizuar nga Qeveria Shqiptare dhe që po zbatohet nga Bashkitë e Qarkut të Tiranës.”**



¹³ <https://www.reporter.al/wp-content/uploads/Kontrate-koncesionare-sharra.pdf>

¹⁴ Vendim i Këshillit Bashkiak (VKB) Nr. 40, datë 23.05.2016 <http://www.tirana.al/wp-content/uploads/2016/11/Vendim-Nr.-40-EcoTirana-Sh.pdf>

¹⁵ Citizens Channel “Pse dështoi ndarja e mbetjeve në burim?” (<https://citizens-channel.com/2019/08/30/tirane-pse-deshtoi-ndarja-e-mbetjeve-ne-burim/>)

¹⁶ Bashkia Tiranë, Kategoria e Publikimit (<https://www.tirana.al/kategoria-e-publikimit/2019/>)

¹⁷ Link i tarifave të reja (VKB 158) <https://www.tirana.al/kategoria-e-publikimit/2019/>




Integrimi Evropian i Shqipërisë & Trajtimi i mbetjeve



Në mënyrë që të arrijë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Shqipëria duhet të përshtasë legjislacionin vendas me atë të komunitetit Evropian. Mjedisi është një nga përbërësit më të mëdhenj të legjislacionit të Komunitetit Evropian dhe një nga fushat më të vështira për të arritur përputhshmërinë.

Sa i takon përgatitjes së Shqipërisë me kuadrin ligjor në fushën e mbetjeve, vihet re një përputhshmëri me direktivat dhe rregulloret e BE-së. Në raportet e fundit të progresit¹⁸ thuhet *qartë se rregullimi ligjor i menaxhimit të mbetjeve ka arritur nivelin më të lartë të harmonizimit me pothuaj 100% përputhshmëri, por sfidë mbetet ende zbatueshmëria e plotë e tij*. Në thelb të përqaqjes Evropiane është zbatimi hierarkisë së mbetjeve¹⁹ sipas së cilës mbetjet mund të trajtohen nëpërmjet:

- 1. Parandalimit**, Përdorimi i sa më pak materialeve në konceptim dhe prodhim. Mbajtja e produkteve më gjatë në përdorim, ripërdorim.
- 2. Ripërdorimit**, Kontroll, pastrim, riparim, rinovim, i të gjithë produktit ose pjesëve të këmbimit.
- 3. Riciklimit**, Kthimi i mbetjes në një substancë apo produkt të ri. Përfshin kompostimin nëse përmbush protokollat e cilësisë.
- 4. Rikuperimit**, Përfshin dekompozimin anaerobik, incinerimin me prodhim energjie. Gazifikimin dhe pirolizën me prodhim energjie dhe materiale nga mbetje.
- 5. Trajtimit përfundimtar/Asgjesimi**. (Depozitim/ Landfill-im dhe Incinerim pa rikuperim energjie)



Për të bërë funksionale skemën e mësipërme, Komisioni Evropian ka propozuar përmes paketës së Ekonomisë Qarkulluese²⁰, 7 targeta të rinj, ku targeti i parë dhe më i rëndësishëm është **realizimi i riciklimit në masën 65% të mbetjeve bashkiake deri në vitin 2030**.

Për vendin tonë, ky target duket të jetë larg arritjes duke konsideruar faktin se nga të dhënat më të fundit, në vitin 2016 janë ricikluar vetëm 17.2 % e mbetjeve totale (me tendenca rënieje nga 2013 - 24%), shtojmë këtu edhe riskun e uljes në vijim të kësaj shifre prej ndërtimit të tre incineratorëve, të cilët për të funksionuar kërkojnë sasi të mëdha mbetjesh të të gjitha llojeve.

¹⁸ Faqja e Komisionit Evropian “Politikat e vendeve fqinj të Bashkimit Evropian dhe negociatat për zgjerim https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en

¹⁹ Ligji kuadër për menaxhimin e mbetjeve, nenin 6

²⁰ Ekonomia qarkulluese http://ec.europa.eu/environment/circular-economy/index_en.htm

➔ Qendrimi i Bashkimit Evropian

Menjëherë pas ndërtimit të incineratorit të parë në Elbasan, në raportin e vitit 2018²¹ për Shqipërinë, në kapitullin 27 për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike, Komisioni Evropian teksa përgëzonte Shqipërinë për landfilllet e reja sanitare, **shprehte edhe shqetësimin e tij lidhur me ndërtimin e incineratorit në Elbasan**, i cili sipas KE është opsioni më pak i preferuar për trajtimin e mbetjeve dhe nuk përshtatet me parimet e BE.

instruments to promote recycling and prevent waste generation remain limited. The construction of an incinerator in Elbasan which started to operate last year and plans for further investment in incinerators pose concerns in terms of compliance with EU principles since disposal and incineration are the least preferred waste management options.

Po ashtu, në raportin e 2019²², Komisioni Evropian shprehte shqetësimin për 199 landfilllet dhe vendepozitimet jashtë standarteve ende të pambyllura dhe për nivelin e ulët të riciklimit apo stimulimeve ekonomike për të promovuar riciklimin dhe shmangur prodhimin e mbetjeve. Gjithashtu, KE shprehej **sërisht i shqetësuar lidhur me tashmë 3 incineratorët që po ndërtohenin në Shqipëri**, vendim që sipas tyre nuk ishte në përputhje me direktivat e BE, se hierkia e mbetjeve e rendiste incinerimin si opsionin më pak të preferuar për trajtimin e mbetjeve dhe se BE nxiste arritjen e targeteve të përcaktuara për riciklimin.

instruments to promote recycling and prevent waste generation remain limited. The construction of an incinerator in Elbasan and the starting of procedures for the construction of two more incinerators in Tirana and Fier pose concerns in terms of compliance with EU Directives on Waste, the waste hierarchy principle with incineration as the least preferred waste management option, and with the EU targets for recycling.

Sipas Eurostat, në viti 2018 BE i menaxhoi mbetjet duke : **ricikluar 48%** - **Mbetje për Energji (Incinerim) 29%** dhe - **Landfillim 23%**.

Vende të ndryshme prodhojnë sasi të ndryshme të mbeturinave dhe kanë qasje të ndryshme për menaxhimin e mbeturinave, zakonisht të lidhura me fuqinë ekonomike. Vihet re një trend i braktisjes së landfilleve në favor të riciklimit dhe djegies.

Sektori i incinerimit mbizotëron në vendet e forta ekonomikisht në Evropën Veriore, Perëndimore dhe Qendrore.

²¹ Raporti për Shqipërinë 2018 (<https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20180417-albania-report.pdf>)

²² Raporti për Shqipërinë 2019 (<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>)



Raporti me Zhvillimin e Qendrueshëm

Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (SDG), u miratuan nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Shqipërinë, në 2015 si një thirrje universale për veprim për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqen dhe prosperitetin deri në 2030.

Për të kuptuar nëse vendi ynë i është afruar arritjes së këtyre objektivave në aspektin e mjedisit dhe specifikisht menaxhimit të mbetjeve, po citojmë dy prej nënçështjeve kryesore:



“Të zvogëlohet ndikimin negativ në mjedis për frymë i qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit, menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera”

“Të zvogëlohet ndjeshëm krijimi i mbetjeve përmes zbatimit të parimeve të parandalimit, reduktimit, riciklimit dhe të ripërdorimit”

Duke ju referuar analizës së mësipërme mbi situatën në të cilën ndodhet vendi ynë, pretendimi i Ministrit të Mjedisit se incenerimi do të zgjidhë përfundimisht problemin e mbetjeve në vend, nuk duket të përputhet me agjendën e Zhvillimit të Qendrueshëm të Kombeve të Bashkuara.





Perceptimi qytetar mbi Incinerimin

Një nga elementët më të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e një politike, e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë qytetarët është informimi dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje. Ky element është detyrim dhe rregullohet nga një sërë aktesh normative.

Mendimi dhe komentet e publikut dhe të OJF-ve, janë kriter i domosdoshëm, gjatë procesit të vendimmarrjes së VNM-së. Konform detyrimeve ligjore të përmendura më sipër, përpara dëgjësës, bëhen publike dokumentet, studimet, analizat dhe informacionet e nevojshëm për projektin që do të ndërtohej, me qëllim që personat e interesuar të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive gjatë konsultimit.

Për të kuptuar dhe mësuar më shumë mbi nivelin e informimit dhe përfshirjes së qytetarëve në këtë vendimmarrje kaq të rëndësishme, ekipi i Qëndresës Qytetare realizoi një pyetësor drejtuar qytetarëve të Qarkut të Tiranës, Fierit dhe Elbasanit ku janë edhe të vendosur tre incineratorët në Shqipëri.

Pyetësorit iu përgjigjën rreth **400 qytetarë, ndër të cilët 225 i përkisnin Bashkisë Tiranë, 85 Bashkisë Fier dhe 90 Bashkisë Elbasan.**




58.7% e të pyeturve janë djem/burra, kurse 41% vajza/gra.

Grupmosha që dominon janë të rinjtë 21-30 vjeç me 38.4%, pasuar nga 22.2% të moshës 41-60 vjeç, 15.3% të moshës 15-20 vjeç, 14% 31-40 dhe 10.1% mbi 60 vjeç.


69.6% e të pyeturve kishin arsim të lartë dhe 28.8% arsim të mesëm.

Të pyetur nëse kishin informacion mbi incineratorët e ndërtuar në Shqipëri, 42.6% nuk janë të informuar mbi ekzistencën e incineratorëve edhe pse ai i Elbasanit ka më shumë se 3 vite që ka nisur ndërtimin dhe më pas funksionimin.

A e dinit se në Shqipëri po ndërtohen 2 incineratorë të rinj (përveç aktualit në Elbasan)?



● Po
● Jo
● Nuk e di




A besoni se incinerimi do të zgjidhë problemin e mbetjeve në Shqipëri?

50.5% e të pyeturve nuk beson se incinerimi si metodë për trajtimin e mbetjeve do të zgjidhë problematikën e madhe të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, teksa 21.4% nuk kanë një opinion lidhur me këtë. Vetëm **28% e tyre mendojnë se incinerimi do të zgjidhë problemin e mbetjeve.**

Në vijim të kësaj, 54% e qytetarëve të pyetur, mendojnë se ka metoda të tjera më të mira për trajtimin e mbetjeve përkundrejt incinerimit, 21.4% e tyre nuk kanë informacion dhe 22.8% e konsiderojnë metodën më të mirë.


A mendoni se djegia e mbetjeve përmes incinerimit është metoda më e mirë për trajtimin e mbetjeve?




Ndërtimi i incineratorëve do të krijojë vende të reja pune për komunitetin

Një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve, **plot 58.5% mendojnë se ndërtimi i incineratorëve do të hapë vende të reja pune**, ndërkohë kujtojmë këtu se në bazë të studimit të fizibilitetit, në Incineratorin e Tiranës do të hapen vetëm 27 vende të reja pune përkundrejt 1200 familjeve të punësuar në sektorin e riciklimit në Tiranë dhe më shumë se 12 mijë personave në të gjithë Shqipërinë. 24.1% e tyre u përgjigjën se mendojnë se nuk do të krijohen vende të reja pune, teksa 17.5% nuk kishin informacion.

A mendoni se incinerimi është i dëmshëm për shëndetin e njeriut?




A mendoni se incinerimi është i dëmshëm për mjedisin në afatgjatë (ndotje e tokave, ajrit, ndotje akustike)?



Të pyetur për ndikimin e incinerimit, 62.7% mendojnë se ai është i dëmshëm për shëndetin, ndërkohë 66.4% mendojnë se ai është i dëmshëm për mjedisin në afatgjatë. Sërish një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve, rreth 20% e tyre edhe për këtë pyetje shprehen se nuk kanë informacion, teksa rreth 14% shprehen se incinerimi nuk është i dëmshëm.

A mendoni se incineratorët kanë rritur/ do të rrisin tarifën e pastrimit për qytetarët?



Së fundi, të pyetur nëse sipas tyre ndërtimi i incineratorëve ka rritur ose do të rrisë tarifën e pastrimit për qytetarët, 60.3% e tyre mendojnë se po dhe në fakt nuk gabohen. Bashkia e Tiranës, me anë të vendimit nr. 158 të Këshillit Bashkiak, të marrë në datën 26.12.2019²³ rriti nga 15% deri në 64% tarifën²⁴ e pastrimit për qytetarët dhe bizneset.

²³ Bashkia Tiranë, Kategoria e Publikimit (<https://www.tirana.al/kategoria-e-publikimit/2019>)


²⁴ Link i tarifave të reja (VKB 158) <https://www.tirana.al/kategoria-e-publikimit/2019>



Gjetjet kryesore



Trajtimi i mbetjeve më anë të **Incinerimit shkon në kundërshtim me Direktivat e BE-së** sipas së cilës hierarkia e mbetjeve e rendit incinerimin si opsionin më pak të preferuar për trajtimin e mbetjeve gjithashtu shkon në drejtim të kundërt me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB.



Edhe pse prej vitesh një nga ministritë më pak të buxhetuara, **Qeveria ka investuar për trajtimin e mbetjeve me anë të incinerimit në total 177 milion Euro**, ndër të cilat 21.6 milion Euro është vlera e investimit për incineratorin e Elbasanit²⁵, 27.4 milion Euro për Incineratorin e Fierit²⁶ dhe 128 milion Euro për incineratorin e Tiranës.²⁷



Industria e riciklimit rrezikon të humbasë plotësisht, kompanitë kanë zvogëluar aktivitetin e tyre, disa janë mbyllur, ndërsa disa të tjerë po planifikojnë që të zhvendosen në vende të tjera, pasi të gjitha mbetjet që gjeneron vendi ynë do të duhet të dërgohen për incinerim.



Incineratorët nuk hapin vende të reja pune, ndryshe nga sa mendojnë reth 60% e qytetarëve të pyetur. Në Tiranë kjo industri do të punësojë vetëm 27 punonjës, ndërkohë që më shumë se 12 mijë persona të angazhuar në mënyrë formale dhe informale në sektorin e riciklimit, rrezikojnë të humbasin vendet e tyre të punës.



Incineratori ka rritur tarifat vendore të pastrimit në Tiranë nga 15-64% për qytetarët dhe bizneset. Në relacion, Këshilli Bashkiak shprehet "se është evidentuar një diferencë e theksuar mes kostos së shërbimit dhe të ardhurave të arkëtuara. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht për shkak të hyrjes në fuqi të kontratës së incineratorit në vitin 2018".



Më shumë se gjysma e qytetarëve të pyetur nuk beson se incinerimi si metodë për trajtimin e mbetjeve do të zgjidhë problemin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, teksa rreth 64% e tyre mendojnë se incinerimi është i dëmshëm për mjedisin dhe shëndetin.

²⁵ <http://opencorporates.al/sq/nuis/l41914013h>

²⁶ <http://opencorporates.al/sq/nuis/l62205045f>

²⁷ <http://opencorporates.al/sq/nuis/l72031013b>



Rekomandimet

1. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - të zbatojë politikat të cilat e ndihmojnë Shqipërinë të shkojë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe sa më afër anëtarësimit në Bashkimin Evropian, konkretisht direktivën për hierarkinë e mbetjeve duke prioritarizuar parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit të monitorojë periodikisht shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë të substancave në dëmshme nga funksionimi i tre incineratorëve në vend, në mënyrë që efektet negative për qytetarët në shëndet dhe mjedis të jenë sa më minimale.

3. Ministritë dhe bashkitë në vend të jenë transparente mbi vendimmarjet e tyre dhe të konsultohen me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile sipas legjislacionit përkatës.

4. Qeveria të rrisë nxitjet dhe subvencionimet për bizneset që ndjekin parimet e Ekonomisë Qarkulluese duke shkuar drejt një kulture me zero mbetje në vend që të nxisë konsumerizmin dhe prodhimin masiv të mbetjeve.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE